

Partnerët Shqipëri hap aplikimet për programin **EDUKIMI I PUNËKËRKUESVE TË RINJ NË SEKTORIN BANKAR**

Panoramë e Përgjithshme

Partnerët Shqipëri shpall thirrjen e dytë për aplikime për programin **“Edukimi i punëkërkuesve të rinj në sektorin bankar”**, për studentët e interesuar ndjekës të vitit të fundit të studimeve Bachelor-Master të shkencave ekonomike në degët Ekonomi, Financë, Bankë, Informatikë-Ekonomike etj.

Pas përfundimit të arsimit të lartë, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve e gjejnë veten të papërgatitur për të përballuar me sukses sfidat e procesit të punësimit. Nëse i referohemi sektorit bankar si një nga sektorët që ofron mundësi të konsiderueshme punësimi për të diplomuarit në shkencat ekonomike, sfiduese mbetet tërheqja e kandidatëve të kualifikuar si potencial rekrutimi, kryesisht për pozicionet e specialistëve apo punonjësve të shërbimit të klientelës. Rekrutimi në sistemin bankar është i prirur për të siguruar kandidatë që performojnë në nivele të larta profesionalizmi për ofrimin e shërbimeve cilësore bankare e financiare për klientët dhe të bërit biznes.

Partnerët Shqipëri, falë eksperiencës disa vjeçare në drejtim të rritjes së kapaciteteve të të rinjve shqiptarë, do të zbatojë këtë program edukimi duke synuar të kontribuojë në përmirësimin e mundësive të punësimit tek të rinjtë shqiptarë të cilët janë duke hedhur hapat drejt karrierës profesionale në sektorin bankar.

Kjo iniciativë vijon si rezultat i eksperiencës së suksesshme të zbatuar gjatë vitit akademik 2016 - 2017, ku një grup prej 12 studentësh përfituan nga programi i ngritjes së kapaciteteve, asistencës dhe mentorimit duke zhvilluar aftësitë bazë të nevojshme për t'u përballur me sukses me sfidat e rekrutimit në sektorin privat në përgjithësi dhe atë bankar në veçanti.

Programi

Programi “Edukimi i punëkërkuesve të rinj në sektorin bankar” i cili ofron mundësi edukimi dhe zhvillimi nëpërmjet metodave më bashkëkohore të të mësuarit dhe ekspertizës shumëdimensionale të lektorëve të angazhuar do t'i mundësojë kandidatëve të përzgjedhur:

1- Ndjekjen e një serie leksionesh në temat:

Dhjetor '17

Sistemi Bankar në Shqipëri. Historiku dhe tendencat e zhvillimit të sektorit;

Dhjetor '17

Banka si institucion. Strukturat organizative, funksionet, shërbimet;

Janar '18

Kërkesat për rekrutim dhe karriera e punës në bankë;

Janar '18

Përgatitja për intervistë pune dhe rekrutimi;

Shkurt'18

Aftësitë për punë dhe përshtatja me mjedisin e punës.

Shkurt'18

Kujdesi ndaj klientit për një shërbim efektiv në sistemin bankar;

2- Mundësi shkëmbimi interaktiv dhe ekspozimi në sektorin bankar.

Pjesëmarrësit më të suksesshëm në program do të referohen në sektorin bankar për t'u konsideruar si kandidatë potencialë në raste pozicionesh vakante në sektor.

Lektorët

Ekspertë të Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, CREDINS Bank, Societe Generale Albania, Tirana Bank dhe të Partnerëve Shqipëri do të angazhohen si lektorë gjatë ciklit të leksioneve.

Procesi i aplikimit dhe përzgjedhja

Nëse jeni të rinj/reja në proces tranzicioni nga “të mësuarit” drejt “karrierës profesionale në sektorin bankar”, të motivuar për të përfituar nga kombinimi i njohurive akademike, vlerave dhe aftësive personale me njohuritë praktike që do të ofrojë ky program, ju ftojmë të aplikoni!

Programi është i hapur për studentë të vitit të fundit të studimeve Bachelor/Master nga universitete publike apo private të degëve Financë, Administrim Biznesi, Ekonomiks, Informatikë-Ekonomike, Kontabilitet/Auditim etj. Të gjithë të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë **Formën e aplikimit** brenda datës **30 nëntor 2017**.

Partnerët Shqipëri do të përzgjedhë **25 pjesëmarrës** për të ndjekur programin. Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.

Vlerësimi i programit në këndvështrimin e përfituesve vjen përmes dëshmimeve të mëposhtme të cilat reflektojnë disa nga arritjet e tyre.

Shprehen përfituesit.....

EDUKIMI I PUNËKËRKUESVE TË RINJ NË SEKTORIN BANKAR

Dajana Belloj

Studente në degën Informatikë – Ekonomike, Universiteti Europian i Tiranës.



“Mësova të prezantohem përmes një CV-je dhe t'i njoh vetes cilësitë dhe motivimin e nevojshëm për zhvillim profesional e karrierë të sigurtë..... Programi, vec dijes përcjell shumë motivim dhe të ofron informacion që vështirë ta marrësh kaq praktikisht nga sistemi akademik... Vlerësoj angazhimin e lektorëve që ndanë dijet dhe eksperiencat e tyre me ne.”

Dajana do të ndjekë programin e praktikës pranë BKT gjatë vitit akademik 2017-2018.

Gilbert Hasballa

Master në Financë-Bankë, Universiteti Europian i Tiranës.



“Pjesëmarrja ka qenë shumë frytëdhënëse për mua në shume aspekte. Kontaktet me profesionistë në sistemin bankar si dhe leksionet praktike bënë të mundur të kuptoj nga afër bankën, kriteret bazë për të qenë pjesë e saj si dhe avantazhet që ofron punësimi në të. Ky program është një investim për karrierën time të ardhshme dhe do të inkurajoja çdo student që ka interesa drejt sektorit bankar, të bëhet pjesëmarrës në mënyrë që të sigurojë kontaktet, dijet por edhe mundësinë e favorshme për një karrierë të suksesshme.”

Fabiola Caushaj

Diplomuar në Informatikë-Ekonomike, Universiteti Europian i Tiranës.



“Ky program më mundësoi zhvillimin e njohurive praktike mbi funksionimin e bankës si institucion, produktet që ofron si dhe politikën e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit ndaj klientit.”

Pjesëmarrja në program i mundësoi Fabiolës praktikën mësimore në BKT. Gjithashtu, Fabiola mori pjesë në ICT Youth Camp dhe një seri programesh të tjera edukuese të ofruara nga Partnerët Shqipëri gjatë vitit 2017.

Xhiliana Preça

Master Shkencor në Financë - Kontabilitet, Universiteti Bujqësor i Tiranës.



“Të prezantohesh profesionalisht në një intervistë pune përmes aftësive komunikuese dhe përgatitjes së dokumentave për aplikim është një sfidë më vete. Do t'ja rekomandoja këtë program çdo të riu në prag diplomimi dhe me interesa punësimi në sektorin bankar, si një mundësi shumë të mirë orientimi dhe zhvillimi në drejtim të njohjes së sektorit dhe përshtatjes në të.”

Xhiliana kandidoi për një pozicion pune të ofruar nga BKT.

Hygerta Shehu

Diplomuar në Financë-Bankë, Universiteti Europian i Tiranës.



“Është një mundësi që padiskutim duhet shfrytëzuar nga kushdo që dëshiron të shkojë përtej njohurive teorike që merren në auditoret e universiteteve, duke lehtësuar kështu procesin e punësimit në sektor.”

Hygerta u përzgjedh dhe punon si “agjente e shitjeve direkte” pranë departamentit të shitjeve direkte në Raiffesisen Bank Albania.

Ana Bojni

Studente në degën Financë-Bankë, Universiteti Europian i Tiranës.



“Programi më ka dhënë një avantazh më shumë kundrejt konkurrentëve të tjerë, për të qenë më e përgatitur dhe e suksesshme në përballjen me tregun e punës. Falë programit zhvillova njohuritë mbi strukturën organizative të bankave, etikën e punës, realizimin e një CV-je perfekte etj. Nuk mund të vlerësoh rëndësinë e programit pa i krijuar vetes mundësinë e ndjekjes së tij.”

Ana mori pjesë në disa programe të ofruara nga Partnerët Shqipëri dhe ka përfunduar procedurat e aplikimit për punësim në një kompani sigurimi.

Klea Mataj

Diplomuar në degën Informatikë-Ekonomike, Universiteti i Tiranës.



“Pjesëmarrja në këtë program është padyshim një investim me vlerë për çdo student në hapat e tij të parë drejt karrierës profesionale. Mundësia për t'u njohur me funksionimin e bankës si institucion si dhe njohja e kërkesave mbi rekrutimin përmes prezantimeve direkte nga përfaqësuesit më të lartë të Burimeve Njerëzore ishte një eksperiencë shumë frytëdhënëse.”

Enxhi Çela

Diplomuar në Financë - Bankë, Universiteti Europian i Tiranës.



“Ky program ofron informacion të nevojshëm për kandidatët e rinj që kanë nevojë për një drejtim në eksperiencën e tyre të punë-kërkimit. Ndjekja e leksioneve nga ekspertë të pozicioneve të larta drejtuese të bankave në Shqipëri dhe mësimi prej eksperiencave të tyre ishin motivuese. Është një program që të ndihmon të integrohesh në një treg kaq të gjerë po aq edhe divers dhe më mësoi se falë përgatitjes dhe etikës në punë shkallët e karrierës ngjiten lehtësisht.”

Enxhi ndoqi edhe programin ICT Youth Camp të ofruar nga Partnerët Shqipëri gjatë muajit qershor 2016.

Vasilika Dhimi

Diplomuar në degën Informatikë – Ekonomike, Universiteti Europian i Tiranës.



“Leksione praktike dhe interaktive të cilat më mundësuar zhvillimin e njohurive mbi funksionimin e sistemit bankar, dhe rritjen e aftësive për të përballuar me sukses një intervistë pune. Ofrimi i praktikave në BKT, Raiffesisen Bank dhe Alpha Bank qenë një mundësi për të njohur më nga afër institucionet.”

Vasilika aplikoi dhe u punësua pranë kompanisë së shitjeve online “DyqanTaxi”.

Lulëzim Salaj

Diplomuar në Financë – Kontabilitet; Master Shkencor në Drejtim Bankar, Univ. i Elbasanit



“Leksione tepër praktike që të krijojnë dëshirën të dëgjoje me orë të zgjatura sepse kishte gjithnjë diçka interesante për të mësuar....Mentorimi i vazhdueshëm, ndarja e informacioneve për pozicione vakante në sektor, mundësitë për pjesëmarrje edhe në programe të tjera për rritjen e kapaciteteve, mbeten një investim domethënës në përgatitjen time profesionale.”

Lulëzimi është punësuar pranë drejtorisë së tatimit-taksave në Berat dhe gjatë muajve të fundit është promovuar në detyrë.

Aleksandra Rrapaj


Diplomuar në Financë, Universiteti i Tiranës.



“Ky program më dha mundësinë të mësoj më tepër nga ana praktike rreth mënyrës se si realisht funksionon sektori bankar, të njohim mënyrën e rekrutimit në banka pra sesi mund të bëhemi pjesë e tyre.”

Kristjana Ibrahim

Master Profesional në Kontabilitet dhe Auditim, Universiteti i Tiranës.



“Mësova dhe zhvillova aftësitë e mia personale dhe profesionale mbi ndërtimin e një CV-je, përgatitjen dhe performancën gjatë një intervistë pune, njohjen e bankës si institucion dhe përshtatjen në ambientin e punës.”